




Kur fëmijët vijjnë të parët



Radiohjälpen
90 1950-6

WE SWEDISH
COOPERATIVE
CENTRE
EFFECT





Ky material është financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect. Radiohjalpen dhe We Effect jo domosdoshmërisht bien dakort me mendimin e shprehur. Vetëm Autori është përgjegjës për përmbajtjen.

Punoi & Redaktoi:

Marsela Isaku

Koordinatore Projekti

Unioni “Amaro-Drom”

©Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri “Amaro-Drom”

Adresa: Rr. Sulejman Pasha,

Lagjia 4, P.2, Shk.3

Telefon/Fax: 00355 4 248925 & 231391

E-mail: amarodrom@abissnet.al

Website: www.unioniamarodrom.com

Tiranë, Shqipëri

Parathënie

Ky botim publikohet në kuadër të projektit "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Rome" financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect, i cili zbatohet nga Unioni "Amaro-Drom në zonat: Korçë, Shkodër, Moravë-Berat, Baltëz-Fier dhe Savër - Lushnje.

Botimi është në funksion të aktiviteteve të projektit dhe njëkohësisht të çështjeve që lidhen me arsimimin e fëmijëve Rom në Shqipëri.

Arsimimi i fëmijëve Rom, është një nga fushat prioritare të Unionit "Amaro-Drom" që në momentet e para të krijimit pasi "Pa arsim nuk ka zhvillim, nuk ka integrim, nuk ka të ardhme".

Një rëndësi e veçantë nga Unioni "Amaro-Drom" i është kushtuar kujdesit të zhvillimit të fëmijërisë së hershme, ku një sërë projektesh të zbatuara, kanë patur në fokus edukimin parashkollor.

Vitet e hershme të jetës, janë të rëndësishme për zhvillimin dhe mirëqënien e fëmijës dhe vendosin themelet për fitimin e aftësive që ndikojnë në të ardhmen.

Mirëqënia dhe shëndeti i fëmijëve tanë, është një çështje që na prek të gjithëve dhe të gjithë duhet të jemi pjesë e zgjidhjeve për krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët.

Një falenderim i veçantë shkon për të gjithë aktorët të cilët kontribuojnë për arsimimin e fëmijëve Rom në Shqipëri. Dëshiroj të falenderoj për mbështetjen në realizimin e këtij projekti, donatorët, Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, drejtuesit e Drejtorive Arsimore Rajonale në Korçë, Shkodër, Fier dhe Berat, Zyrën Arsimore në Lushnje, Drejtoritë dhe edukatorët e kopshteve të projektit dhe stafin e projektit.

Çdo fëmijë duhet të ndihet i vlerësuar dhe të ketë mundësi të zhvillojë potencialin e tij. Letë përpiqemi të gjithë së bashku t'u ofrojmë fëmijëve tanë një mjedis të sigurt, të ngrohtë!



Sinqerisht,
Skënder Veliu
Drejtor Ekzekutiv
Unioni Amaro Drom



Përmbajtja

I

PËRFUNDON FAZA E PARË DHE FILLON ZBATIMI I FAZËS SË DYTË PËR PROJEKTIN "PLATFORMA KUNDËR VARFËRISË SË FËMIJËVE DHE PËRJASHTIMIT SOCIAL NË KOMUNITETET ROME NË SHQIPËRI"

... Faqe 4

II

ROLI I ARSIMIT PARASHKOLLOR NË ZHVILLIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME

... Faqe 4

III

RËNDËSIA E REGJISTRIMIT TË FËMIJËVE

... Faqe 4

IV

TRAJNIM ME PRINDËRIT: "ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS DHE ROLI I PRINDËRVE NË ULJEN E DISKRIMINIMIT"

... Faqe 4

V

SHKËMBIM EKSPERIENCE MIDIS STAFEVE EDUKATIVE NË SHKODËR

... Faqe 4

VI

"HISTORIA JUAJ" AKTIVITETI QË SYNON PËRMIRËSIMIN E AFTËSIVE PRINDËRUESE TË NËNAVË ROME

VII

KËSHILLA MIQËSORE PËR PRINDËRIT

... Faqe 4

VIII

KËSHILLA MIQËSORE PËR EDUKATORET

... Faqe 4

PËRFUNDON FAZA E PARË DHE FILLON ZBATIMI I FAZËS SË DYTË PËR PROJEKTIN “PLATFORMA KUNDËR VARFËRISË SË FËMIJËVE DHE PËRJASHTIMIT SOCIAL NË KOMUNITETET ROME NË SHQIPËRI”

Në muajin Mars 2017, përfundoi zbatimi i fazës së parë të projektit “Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Rome në Shqipëri”. Arritjet e këtij projekti u prezantuan gjatë një eventi përmbyllës të organizuar nga Unioni “Amaro-Drom” në Tiranë.

Ky event mbledhi bashkë shumë aktorë të cilët janë angazhuar dhe kanë bashkëpunuar në realizimin e aktiviteteve të projektit, si: përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Drejtorive Arsimore, drejtuesit e kopshteve, edukatorët, mjekët, koordinatore të lokalë, përfaqësues të organizatave rome, antarë dhe aktivistë rom.

Gjatë aktivitetit u mbajtën fjalë përshëndetëse nga pjesëmarrësit dhe u dhanë mesazhe të ndryshme mbi rëndësinë e arsimit.

Z. Skënder Veliu, Drejtor Ekzekutiv i Unionit “Amaro-Drom” u shpreh se çështja e arsimit të fëmijëve është një çështje e rëndësishme dhe Unioni Amaro-Drom i ka kushtuar vëmendje maksimale përmes zbatimit të projekteve të ndryshme, duke filluar nga niveli parashkollor dhe me rradhë. Qëllimi i këtyre projekteve është që të rritet niveli i përfshirjes së fëmijëve rom në arsimin public, të përmirësohet niveli i ndërgjegjësimit midis prindërve të komunitetit Rom për rëndësinë e arsimit, të përmirësohet cilësia e mësimdhënies në mënyrë që kopshtet dhe shkollat të jenë sa më miqësore me fëmijët.

Sipas Z. Veliu, përfshirja e fëmijëve rom në arsim është një sfidë e vazhdueshme për shkak të shumë faktorëve pengues, megjithatë Unioni “Amaro Drom” është i vendosur të vazhdojë të mbështesë fëmijët e komunitetit Rom me qëllim rritjen e aksesit të tyre ndaj një të drejte themelore siç është arsimimi.

Z. Besnik Rama, përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, nënvizoi se Ministria e ka një ndër çështjet prioritare të punës së saj përfshirjen e fëmijëve në shkollë. Themelet e edukimit janë nga kopshti parashkollor dhe për këtë arsye mbështetja e fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç është një bazë shumë e mirë për të patur rezultate positive në të ardhmen.

Z. Besnik Rama gjatë fjalës së tij vlerësoi punën e Unionit "Amaro-Drom" ndër vite dhe veçanërisht gjatë zbatimit të këtij projekti. Ministria i sheh organizatat e shoqërisë civile rreth si partnerë të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në arritjen e përmbushjes së misionit të përbashkët për arsimimin e të gjithë fëmijëve shqiptarë dhe ofrimin e kushteve të barabarta dhe mundësive për t'u arsimuar, të gjithë fëmijëve.

Edukatoret, koordinatorët lokalë, dhe mjeket ndaë eksperiencat e tyre në punën gjatë zbatimit të projektit dhe falenderuan donatorët për mbështetjen e ofruar.

Arritjet e projektit u prezantuan nga Koordinatorja e Projektit, **Znj. Marsela Isaku**, disa prej të cilave listohen në vijim së bashku me objektivat e vendosura në fillim të projektit:

Objektivat

Objektivi 1-rë

Përmirësimi i aksesit ndaj shërbimeve cilësore të fëmijërisë së hershme



- **164 fëmijë** janë asistuar për t'u regjistruar ne kopshte për vitin shkollor 2015-2016; 254 fëmijë për vitin shkollor 2016- 2017; **54 fëmijë 6-vjeçarë** janë regjistruar ne klasë të parë;
- **8 edukatore** të trajnuara në vendin e punës nga specialistë të Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA);



Shkëmbim eksperience midis stafeve edukative (Korçë, Shkodër, Moravë, Baltëz);



35 lider komuniteti të trajnuar mbi shërbimet për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, menaxhimi I marrëdhënieve në komunitet dhe fuqizimi i bashkëpunimit me Pushtetin lokal;



Tryeza të rrumbullakta me pjesëmarrjen e ofruesve të shërbimeve në nivel lokal.

Objektivat

Objektivi 2-të



- 5 Kopshte (11 klasa) të pajisur me pajisje dhe materiale didaktike të nevojshme për zhvillimin e programit mësimor (tavolina , karrrike,rafte, libra për fëmijët, tapete, TV, dvd, ngrohës etj).

- 164 fëmijë janë pajisur me mjetet didaktike bazë për vitin shkollor 2015-2016;



- 254 fëmijë për vitin shkollor 2016-2017 (uniforma, libra didaktike, mjete kancelarike, çanta);



- 164 fëmijë janë pajisur me mjetet didaktike bazë për vitin shkollor 2015-2016;



Objektivat

Objektivi 3-të

Rritja e ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e regjistrimit civil, edukimit të hershëm dhe shëndetit të fëmijëve.



1,000

kopje flet-palosjesh të publikuara dhe shpërndara në zonat e projektit dhe degët e Amaro-Drom.

2 Buletine

vjetore të publikuara dhe shpërndara në zonat e projektit.

5 sesione

trajnimi mbi mbi të drejtat e fëmijëve, zhvillimin e fëmijërisë së hershme dhe prinderimin (për secilin komunitet)

2

Konferenca kombetare në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.




Aktivite festive për 8 Prillin, Vitin e Ri dhe shpërndarje dhuratash për fëmijët.



Objektivi 4-t

Përmiresim i gjëndjes shëndetësore të fëmijëve si dhe sjelljes së prindërve për të parandaluar sëmundjet.

Vizita shëndetësore periodike për të gjithë fëmijët në kopësht;

- Kartela mjekësore të hapura për të gjithë fëmijët;
- Konsulta mjekësore  për prindërit e fëmijëve ;
- Kite higjienike të dhuruar për të gjithë fëmijët e kopshtit .
- 336 raste të regjistrimit civil të zgjidhura falë ndihmës së projektit.
- sesione informuese mbi rëndësinë e regjistrimit civil në të gjitha zonat e projektit.

Në vijim të rezultateve të arritura gjatë fazës së parë, në muajin Prill 2017 filloi të zbatohet faza e dytë e këtij projekti. Projekti do të zbatohet deri në Dhjetor të vitit 2019 në zonat Korçë, Shkodër, Baltëz-Fier, Moravë-Berat dhe Savër-Lushnje, zonë e cila u shtua për këtë fazë të dytë.

Gjithashtu, është shtuar edhe një aktivitet i ri i cili synon të rrisë angazhimin e nënave. Ky aktivitet do të mbledhe nënat e fëmijëve në mënyrë periodike dhe përmes librave me përralla që do të dhurohen nga projekti do synohet forcimi i marrëdhënieve nënë-fëmijë-kopësht.

ROLI I ARSIMIT PARASHKOLLOR NË ZHVILLIMIN E FËMIJËRISË SË HERSHME

Vitet e fëmijërisë së hershme – që përmbledhin periudhën 0-6 vjeç – përbëjnë një nga periudhat më të rëndësishme të zhvillimit të njeriut. Gjatë këtyre vetive fëmijët formojnë personalitetin e tyre, zhvillojnë aftësitë sociale, të folurit, të menduarit. Këto realizohen si në familje, në komunitetin ku fëmija bën pjesë, por sidomos nëpërmjet programeve që zhvillohen në arsimin parashkollor.

Arsimi parashkollor është një shërbim që u ofrohet fëmijëve të grup moshës 3-6 vjeç dhe ka si objekt kryesor socializimin e tyre, duke mbështetur, mundësuar dhe lehtësuar zhvillimin e këtyre fëmijëve. Procesi i edukimit parashkollor ka si qëllim të realizojë një përvojë dhe mënyrë edukimi të veçantë e personale për çdo fëmijë dhe grup fëmijësh.

Duke patur parasysh aftësitë e jashtëzakonshme të të nxënësve në këtë moshë, edukimi parashkollor përbën gurin e themelit për të gjitha nivelet arsimore. Ka ardhur koha që arsimi parashkollor të mos ketë vetëm një rol ndihmës, sepse ndërhyrja cilësore në fëmijërinë e hershme ka një normë të lartë kthyeshmërie në të gjithë sistemin e arsimit të detyrueshëm dhe për të gjithë personat që përfitojnë nga kjo ndërhyrje.

Edukimi parashkollor “me fëmijën në qendër”, bazohet në disa parime themelore ku fëmijët përfitojnë njohuri, zotërojnë shkathtësi dhe shprehin të ndryshme, fitojnë përjetime nga ndërveprimet me botën që i rrethon, kurse të rriturit (prindërit, edukatorët dhe të tjerët) nxisin rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve, duke vënë në bazë të punës mundësitë, interesat, nevojat dhe aftësitë e fëmijëve.

Pra, filozofia “me fëmijën në qendër” mundëson krijimin e kushteve për zgjimin e mundësive dhe për zhvillimin e potencialeve individuale të fëmijëve. Nga kjo rezulton se edukimi parashkollor duhet t`u mundësojë fëmijëve shprehjen dhe zhvillimin aktiv të nevojave, interesave njohëse, botës emocionale dhe aftësive të tyre.

Loja aktive është veprimtaria më qenësore e fëmijëve të moshës parashkollore. Loja duhet t`u mundësojë fëmijëve t`i zhvillojnë aftësitë motorike e njohëse, pastaj, duke bashkëvepruar me moshatarët, t`i kultivojnë shprehitë shoqërore dhe aftësitë sociale dhe, duke i zotëruar sfidat individuale e shoqërore, të zhvillohen edhe në aspektin mendor, emocional dhe moral. Loja aktive dhe atraktive për fëmijën parashkollor dhe grupin, luan rol edhe në krijimin e atmosferës së përshtatshme për jetë të shëndoshë, bashkëveprimin social. Fëmija dhe të rriturit duhet të kuptojnë se të nxënit është proces shumë dimensional gjatë të cilit fëmijët mësojnë nga njeri-tjetri, mësojnë nga të rriturit, por edhe të rriturit mësojnë nga fëmijët. Ka, pra, rrugë të ndryshme për t`u arritur një qëllim dhe pikërisht për këtë duhet, jo t`iu imponohen fëmijëve idetë apo zgjidhjet, por të inkurajohen të provojnë të bëjnë diçka të re dhe idetë e përvojat e tyre t`i ndajnë me të tjerët.

RËNDËSIA E REGJISTRIMIT TË FËMIJËVE





Neni 7 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve parashikon të drejtën e fëmijës për të pasur një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre. Për të siguruar aksesin në të gjitha shërbimet, kusht i domosdoshëm është regjistrimi i çdo fëmijë pranë Gjendjes Civile.

Romët përballen me sfida të integritit social dhe ekonomik, ndërsa të drejtat e tyre njerëzore e kombëtare shkelen përditë. Fëmijët braktisin shkollat, prindërit janë pa banesa e pa punë dhe nuk përfitojnë nga kujdesi shëndetësor dhe social. Varfëria në mesin e romëve është e përhapur gjerësisht, po aq sa edhe mënjanimi social ekonomik.

Ligji për gjendjen civile ka lehtësuar deri diku procedurat për regjistrimin e fëmijëve në situatë rruge që shpesh vijnë nga familje në nevojë, familje në kushte të vështira social-ekonomike, të përjashtuara dhe të diskriminuara, me burime të kufizuara financiare dhe arsimore.

Pavarësisht përmirësimeve në ligj, praktika e punës me fëmijët në situatë rruge ka nxjerrë në pah disa probleme që po i paraqesim në vazhdim sikurse janë identifikuar nga specialistët e terrenit: "Shumë nga problemet me të cilat përballen fëmijët e rrugës por edhe shumë fëmijë të tjerë e kanë zanafillën tek dokumentacioni që përgatitet me ardhjen e tyre në jetë.

Akti i lindjes që lëshohet nga shtëpia e lindjes nuk është i formalizuar. Të dhënat shpesh nuk përputhen me njëra-tjetrën. Fillon kështu problemi me regjistrimin. Një fëmijë me probleme dhe pikëpyetje në dokumentacion nuk mund të regjistrohet. Në momentin që nuk regjistrohet, fillon vargu i problemeve.

Ai nuk mund të marrë shërbimin shëndetësor falas, nuk mund të përfitojë nga shërbimet sociale, nuk mund të regjistrohet në shkollë etj. "Për të bërë regjistrimin kërkohet plotësimi i disa kushteve që ndonjëherë është e pamundur të përmbushen nga familjarët siç mund të jetë kërkesa për të pasur një kontratë të vlefshme qiraje.

Në praktikën e përditshme ndeshim, brenda një familjeje, deri në tre breza të peregjistruar për shkak të mospasjes së një kontrate banimi, të një vendi të përherëshëm banimi, të dokumentacionit të lindjes etj". "Megjithëse Ligji për Regjistrin Civil është përmirësuar, ka ende vështirësi për fëmijët romë.

Fëmijët romë e kanë të pamundur të regjistrohen si individë. Kur familja është e peregjistruar, ata mbeten të peregjistruar. Në të tilla kushte, ata mund të përfitojnë vetëm nga shërbimi për kryerjen e vaksinimit falas.

Shpeshherë, regjistrimi i fëmijës kushtëzohet nga pagesa e taksave vendore. Shumë nga familjet e varfra (rome dhe jo rome) nuk kanë mundësi të paguajnë taksat vendore. Anëtarët e këtyre familjeve kanë të ardhura të kufizuara, janë të papunë ose marrin pagesë papunësie (si pjesë e skemës së ndihmës ekonomike të pushtetit vendor).

Në këto kushte, të ardhurat e tyre janë shumë më të ulëta sesa niveli i taksave për t'u paguar. Të gjendur përpara vështirësive të tilla, ata zgjedhin të mos regjistrojnë fëmijën e tyre!" "Me mënyrën se si funksionon sistemi sot, regjistrimi lihet në dorë të familjes. Në fakt, institucioni duhet të jetë përgjegjës për nisjen e procedurës së regjistrimit. Kjo do të bënte që çdo familje, pavarësisht kushteve, nivelit dhe mundësive, të detyrohej të bënte regjistrimin e fëmijës duke i hapur rrugën respektimit të të drejtave dhe nevojave të fëmijës".

Për rëndësinë që ka regjistrimi civil, Unioni Romëve "Amaro-Drom" e ka përfshirë atë si një komponent të rëndësishëm në projektin "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Romë në Shqipëri" i cili është duke u zbatuar në Korçë, Shkodër, Fier, Berat dhe Lushnje me mbështetjen e Eë effect dhe Radiohjalpen.

Në rol të rëndësishëm në këtë proces luajnë koordinatorët lokalë të cilët bëjnë identifikimin e rasteve në terren. Në varësi të specifikave që ka secili rast, bëhet dhe menaxhimi i tij me qëllim final zgjidhjen e tij dhe regjistrimin e lindjes së fëmijës në gjendje civile. Bazuar në eksperiencën e deritanishme, rastet variojnë nga ato më të thjeshtat ku disponohen të gjitha dokumentat por nuk është bërë regjistrimi për shkak të neglizhencës nga ana e prindit, deri në ato me komplekset ku ka mungesë dokumentacioni dhe zgjidhja e vetme është ajo përmes ndjekjes në gjykatë.

Në të gjitha zonat ku zbatohet projekti, Unioni Amaro-Drom ka organizuar seanca informimi me pjesëmarrjen e antarëve të komunitetit rom. Qëllimi i këtyre seancave ka qënë rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit Rom mbi rëndësinë që ka regjistrimi civil dhe njëkohësisht dhënia e informacionit mbi procesin e regjistrimit.

Një nga sfidat e punës së Amaro-Drom mbetet regjistrimi i fëmijëve në situatë rruge për shkak të indiferentizmit dhe mungesës së angazhimit nga ana e prindërve.

Prindërit janë aktorë shumë të rëndësishëm në këtë proces dhe ata duhet të ndërgjegjësohen për detyrimin dhe përgjegjësinë prindërore që kanë ndaj fëmijëve të tyre.

Ndërkohë, janë edhe një sërë rastesh suksesi të cilat na motivojnë për të vazhduar misionin tonë. Një ndër këto raste, është ai i një familje me tre fëmijë të pa regjistruar për shkak të pamundësisë ekonomike në ndjekjen e procedurave gjyqësore të nevojshme. Rasti aktualisht është drejt zgjidhjes falë mbështetjes së projektit dhe shumë shpejt të tre fëmijët, do të kenë kenë një identitet dhe mundësinë për të përfituar nga të gjitha shërbimet publike, si të gjithë bashkëmoshatarët e tyre.



Përmbledhje e rasteve të indentifikuar, përfunduar dhe në proçes sipas komuniteteve.

JANAR – NËNTOR 2017					
Nr	Komunitetet	Raste të indentifikuar	Raste të zgjidhura	Raste në proçes	Shërbime të tjera
1	Korçë	38 raste (16-femra)	38 raste (16 femra)	0	0
2	Moravë	23 raste (15- femra)	23 raste (15 femra)	0	0
3	Baltëz	67 raste (31 femra)	64 raste (29 femra)	3-Lindje	3 raste me gjykatë
4	Shkodër	33 raste (17-femra)	33 raste (17-femra)	0	0
5	Savra	30 raste (8-femra)	30 raste (8-femra)	0	0
TOTALI		191 raste (87-femra)	188 raste (85-femra)	3-Lindje	0
TOTALI Progresiv		462 raste (226-femra)	459 raste (224-femra)	3-Lindje	4.LM+9.ID+3.GJYK



*Përgatiti: **Ferit MILANJ**
Lehtësues i proçesit të regjistrimit civil*

TRAJNIM ME PRINDËRIT:

“ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS DHE ROLI I PRINDËRVE NË ULJEN E DISKRIMINIMIT”

Në kuadër të projektit “Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Romë në Shqipëri – Faza 2” u zhvillua seanca e parë e trajnimit me temë “Arsimi gjithëpërfshirës dhe roli i prindërve në uljen e diskriminimit në 5 komunitete përfituese të projektit.

» Çështjet kryesore të trajtuara gjatë modulit të parë të trajnimit

Seanca e parë e trajnimit u fokusua në rëndësinë e arsimit në fëmijërinë e hershme në përgjithësi dhe atij gjithëpërfshirës në vecanti si dhe rolin që kanë prindërit në reduktimin e diskriminimit ndërmjet fëmijëve nëpër shkollat gjithëpërfshirëse, specifikisht si në më poshtë:

1. Arsimi gjithëpërfshirës, e drejtë e gjithësecilit - Çfarë do të thotë gjithëpërfshirje?
2. Problematikat kryesore që komuniteti Rom has në procesin e arsimit gjithëpërfshirës - Diskriminimi
3. Përfitimet prej arsimit gjithëpërfshirës:
 - Nxjerrja në pah e vlerave njerëzore
 - Pranim dhe vlerësim i diferencave individuale
 - Rritje e bashkëveprimit me bashkëmoshatarët- çdokush mund dhe duhet të ketë miq!
 - Rritje e motivimit dhe zgjerim i interesave të fëmijës
 - Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse
4. Mite dhe fakte: besimet e gabuara mbi ndikimet e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijët vulnerabël (fëmijët e komunitetit Rom, Egjiptian dhe atyre me aftësi të kufizuar) dhe të fëmijët e tjerë të mazhorancës, me qëllim sfidimin e këtyre besimeve jo racionale që vështirësojnë procesin e integritit të fëmijëve vulnerabël në arsimin gjithëpërfshirës.

5. Roli i prindërve si faktorë kyç në integrimin e fëmijës në arsimin gjithëpërfshirës dhe reduktimin e diskriminimit ndërmjet fëmijëve në mjedisin e shkollës dhe më gjerë – Cfarë duhet të bëjmë?
- Të luftojmë se pari me paragjykimet tona
 - Të përdorim një gjuhë të kujdesshme dhe jo etiketuese
 - Të zgjerojmë rrethin tonë njohjeve dhe miqve me prindër të komuniteteve të ndryshme
6. Si të flasim me fëmijën rreth ndryshimeve racore – Keshilla praktike rreth sjelljes së prindit si model i sjelljes së fëmijës së tij në të ardhmen

» Mbarëvatja e seancës së parë të trajnimit në komunitetet përkatëse

Kryesisht seancat e trajnimit në komunitetet përkatëse u zhvilluan në formën e diskutimeve me prindërit pjesëmarrës në mënyrë që përfshirja e tyre të ishte më e plotë por njëkohësisht të evidentoheshin edhe problematikat kryesore që komunitetet hasnin në lidhje me çështjet e trajtuara. Pjesëmarrës në trajnim ishin kryesisht nëna dhe gjyshe të komunitetit rom, egjiptian dhe mazhorancës. Vetëm në njërin prej komuniteteve (Berat) kishte pjesëmarrje edhe te babait dhe gjyshit të të 2 fëmijëve të komunitetit rom. Pjesëmarrësit u prezantuan me trajnuesen, temën që do të diskutohej dhe më pas secili prezantoi veten e tij duke ndarë një informacion të shkurtër rreth fëmijëve, nipërve apo mbesave dhe nëse ata ishin të integruar në shkolla apo kopshte, si një mënyrë për të thyer akullin në takimin e parë me trajnuesen. Kjo ishte gjithashtu dhe një mënyrë për të kuptuar se cila ishte përbërja e grupit, interesi i tyre në çështjen e arsimit dhe nivelin e integritit të fëmijëve të tyre në shkollë.

Përbërja e grupit të të trajnuarve ishte e ndryshme. Në bazë të përbërjes së grupit të prindërve dhe të problematikave që prindërit ngritën në lidhje me çështjen, trajnimi u fokusua me tepër në rëndësinë që ka përfshirja e fëmijës në shkollë jo vetëm për tu aftësuar në aspektin akademik por edhe njerëzor, siç ishte parashikuar në modulën e parë si dhe se si ky proces ndikon në reduktimin e diskriminimit. Me grupin e pjesëmarrësve përveç diskutimeve, ndarjes së eksperiencave ndërmjet njeri-tjetrit dhe ndarjes së informacionit teorik nga trajnuesja, u zhvillua edhe një lojë për të kuptuar më mirë efektin e diskriminimit, ndjesinë që ajo i përcjell personit të diskriminuar si dhe rëndësisë që ka jo vetëm gjuha që përdorim për të etiketuar të tjerët por edhe sjellja jotë jo vebrale, gjuha e trupit, mimika e fytyrës sonë.

Te të gjitha komunitetet u vu re se me përmirësimin e kushteve fizike të klasave, prindërit tregoheshin më të gatshëm dhe më pozitivë ndaj qasjes së fëmijëve në shkollë dhe kopësht dhe ishin të aftë të evidentonin disa ndryshime pozitive që fëmijët mund të kishin. U vu re se pothuajse të gjithë fëmijët e moshës parashkollore dhe cikël i ulët ishin të përfshirë në kopshët dhe shkollë. Në disa prej komuniteteve (Korçë dhe Fier më së shumti), prindërit ishin të interesuar në lidhje me mbarëvajtjen e fëmijëve në kopësht apo shkollë, tregonin interes pranë edukatoreve ose mësueseve për të ditur mbi ecurinë e fëmijës, përfshiheshin aktivisht në diskutime në lidhje me rëndësinë e shkëollimit.

Ajo cka u vu re në të gjitha komunitetet ishte përfshirja më e pakët e vajzave në arsim. Pjesa më e madhe pranonin se si rrjedhojë e traditës, vajza mund të bënte kryente vetëm ciklin e parë ose të dyte dhe më pas të qëndronte në shtëpi dhe të kujdesej për familjen apo të krijonte familjen e saj.

Megjithatë jo të gjitha grupet kishin të njejtin nivel interesi. Sic u përmend më lartë, vu re një nivel më i lartë interesi tek prindërit e komunitetit rom në Korçë dhe në Fier, ishin më aktivë gjatë diskutimit dhe më të hapur për të ndarë eksperiencat e tyre, qoftë ato pozitive ashtu edhe ato negative në lidhje me përfshirjen e fëmijëve të tyre në arsimin gjithëpërfshirës, rastet kur fëmijët kishin hasur diskriminim dhe mënyrën se si e kishin menaxhuar këtë situatë. Ndarja e eksperiencave ndërmjet prindërve ishte shumë pozitive pasi pati raste ku prindërit u vete-ndergjegjesuan në rastet kur kishin shkëputur fëmijët nga shkolla si pasojë e diskriminimit dhe tregonin se si pasojat e këtij veprimi shfaqeshin sot dhe fëmija, tashmë i rritur nuk ishte i aftë as të shkruante e lexonte. Ndarja e eksperiencave nga vete antarët e komunitetit rom jepte shembuj konkret të rëndësisë që arsimeri ka të fëmijët dhe njëkohësisht u shfrytëzua ky moment për të ndihmuar prindërit e fëmijëve, se si të reagonin në rastet kur fëmija i tyre përballej me diskriminim, si t'a këshillonin apo ndihmonin fëmijën.

Sic u përmend më sipër, përbërja e grupit të prindërve ishte e ndryshme në komunitete të ndryshme. Në komunitetin e zonës së Savrës, Lushnjë ishin pjesëmarrës prindër nga mazhoranca dhe prindër të komunitetit rom, fëmijët e të cilëve ishin të integruar së bashku në të njejtën shkollë. U vu re një pjesëmarrje më aktive e prindërve të mazhorancës dhe një nivel i lartë konformimi i komunitetit rom me mendimet e prindërve të mazhorancës dhe refuzim për të ndarë problematikat reale që kishin lidhje me diskriminimin. Më anë të pyetjeve shumë specifike dhe nxitëse, prindërit e komunitetit rom pranuan të flisnin më hapur për problematikat që haseshin përse i përket diskriminimit dhe problematikave që lindin prej tij ndaj u pa e nevojshme që të qëndrohej më gjatë në rëndësinë që prindërit e fëmijëve të mazhorancës kanë në reduktimin e diskriminimit ndërmjet fëmijëve të mazhorancës dhe komuniteteve të tjera, meqënëse përbërja e grupit ishte e përzier. Nga ana tjetër, prindërit e komunitetit rom, u shfaqën më pasiv në rastin kur duhet të nxisnin fëmijët e tyre për të frekuentuar shkollën, duke nxjerrë në pah arsye ekonomike, infrastrukture.

Në komunitetin e Shkodrës pjesa dërrmuese e pjesëmarrësve i përkisnin komunitetit Egjiptian. Cështja kryesore që doli nga bisedat paraprake gjatë prezantimit me pjesëmarrësit ishte niveli i lartë i diskriminimit ndërmjet komunitetit Rom dhe Egjiptian në këtë zonë. Si rrjedhojë u pa e rëndësishme që përgjatë seancës së trajnimit të theksohej se sa e rëndësishme është që vetë prindërit të jenë pranues së pari me antarët e komuniteteve të tjera, në mënyrë që këtë frymë t'ja përcojnë edhe fëmijëve të tyre, çka do të ndikojë edhe në përfshirjen e tyre në arsimin gjithëpërfshirës dhe në jetën e tyre në të ardhmen.

KONKLUZIONE

- » Përmirësimi i kushteve fizike të kopshteve ose shkollave shërbente si shtysë për prindërit që t'i angazhonin dhe integronin fëmijët e tyre në kopësht/shkolla.
- » Parimisht prindërit e komunitetit rom, pranonin rëndësinë e arsimit tek fëmijët.
- » Në zonën e Moravës (Berat) dhe Shkodrës prindërit shfaqën nivel më të ulët interesi dhe pjesëmarrjeje në lidhje me cështjen e arsimit dhe kishin tendencën që ta shihnin kopshtit apo shkollën më tepër si një mjedis ku fëmija qëndron i vëzhguar se sa si një mjedis edukimi dhe arsimit me rëndësi për të ardhmen e tij.
- » Komuniteti rom në Korçë dhe në Fier, pati numërin më të lartë të pjesëmarrësve. Ata vetëm pranonin por edhe kuptonin më mirë rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës tek fëmijës e tyre dhe tregonin interes ndaj këtij procesi. Edhe niveli i diskriminimit në këto zona u pa të ishte më i ulët, nisur nga diskutimet dhe dëshmitë e prindërve.
- » Në komunitetin egjiptian në Shkodër u ekzistonin nivele të larta diskriminimi ndërmjet komuniteteve (rom, egjiptian dhe mazhorancës).
- » Përfshirja e vajzave në arsim ishte problematike në të gjitha komunitetet, si rrjedhojë e traditës, sipas rrefimeve të pjesëmarrësve në trajnim dhe ndarjes së eksperiencave të tyre.
- » Nga diskutimet me prindërit (ose gjyshet), përsa i përket fëmijëve të prindërve të përshirë në trajnim, pothuajse të gjithë fëmijët në moshë të hershme ishin të përfshirë në kopësht/shkollë, pavarësisht nivelit të frekuentimit, ndërsa fëmijët më të rritur, kryesisht ata që kalonin moshën e ciklit 9 vjeçar, e ndërprisnin shkollën.

REKOMANDIME

- » Zhvillimi i një sesioni trajnimi mbi rëndësinë e përfshirjes së vajzave në shkollë
- » Krijimi i lehtësirave fizike të mëtejshme si transporti do të rriste nivelin e frekuentimit
- » Organizimi i mbledhjeve me prindër në shkollë ose kopësht të paktën një herë në muaj, ku të gjithë prindërit e fëmijëve të jenë prezent. Në këtë mënyrë do të theksohet rëndësia e përfshirjes aktive të prindërve në mbarëvatjen e fëmijëve në shkollë.
- » Monitorimi i vazhdueshëm i mësuesve në lidhje me orarin e frekuentimit të shkollës/kopshtit nga fëmijët, në mënyrë që ata të qëndrojnë përgjatë gjithë orarit të paracaktuar në kopësht apo shkollë dhe të përfitojnë maksimalisht nga koha e kaluar aty.
- » Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta argëtuese si shfaqje me role, recitime, këngë, në ambjentet e shkollës/kopshtit ku fëmijët e të gjithë komuniteteve dhe prindërit e tyre të jenë të përfshirë do të ndihmonte në rritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe reduktimin e diskriminimit

SHKËMBIM EKSPERIENCË MIDIS STAFEVE EDUKATIVE NË SHKODËR

Në datat 9-10 Nëntor 2017, u organizua aktiviteti shkëmbim eksperience midis stafeve edukative të kopshteve "Azem Quka" Savër dhe kopshtit Nr. 10 Korçë në kopshtin "Liria" në Shkodër. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit "Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në komunitetet Rome – faza 2" financuar nga Radiohjalpen dhe We Effect, i cili zbatohet nga Unioni "Amaro-Drom" në zonat Korçë, Shkodër, Baltëz-Fier, Moravë-Berat dhe Savër Lushnje.

Aktualisht Unioni "Amaro-Drom" është duke zbatuar fazën e dytë të projektit ku përveç kopshteve të përfshira në fazën e parë, janë shtuar edhe kopshti "Azem Quka" Savër dhe kopshti Nr. 10 Korçë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të kontribuonte në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe shkëmbimin e eksperiencës midis stafeve edukative të kopshteve të targetuara nga projekti. Në këtë aktivitet morrën pjesë edukatorët, drejtorët e kopshteve dhe koordinatorët lokalë.

Pjesëmarrësit ndoqën zhvillimin e një ore mësimore në kopsht, ku patën mundësinë të njihen me metodat e mësimdhënies dhe si organizohet një orë mësimi. Gjithashtu, stafet edukative diskutuan midis tyre në lidhje me modelet pozitive dhe sfidat me të cilat ata përballen gjatë përditshmërisë në punën e tyre.

Pas vizitës në klasën që ndodhet brenda ambjenteve të shkollës "Liria", pjesëmarrësit vizituan klasën tjetër, e cila është po në varësi të shkollës, por ndodhet në ambjentet e Fshatit të Paqes. Ky është një model shumë pozitiv bashkëpunimi dhe sinergjie midis aktorëve të ndryshëm dhe projekteve. Kopshti është hapur bazuar në nevojën e komunitetit, pasi ndodhet afër vendbanimit të fëmijëve. Familjet e këtyre fëmijëve përballen me probleme të shumta social-ekonomike. Ndërkohë fëmijët kanë gjetur një ambjent të ngrohtë falë punës së stafit të angazhuar dhe mbështetjes që ofron Fshati i Paqes me ofrimin e një vakti ushqimor por edhe mbështetjes me bazë materiale që i jep projekti i zbatuar nga Unioni "Amaro-Drom".

Pjesëmarrësit u larguan me përshtypjet më pozitive në lidhje me të gjithë punën që është bërë në këtë kopsht dhe me dëshirën për të zbatuar në vendin e tyre të punës modelet pozitive që vëzhguan nga afër në kopshtin "Liria" në Shkodër.

“HISTORIA JUAJ” AKTIVITETI QË SYNON PËRMIRËSIMIN E AFTËSIVE PRINDËRUESE TË NËNAVË ROME

“Historia juaj” është aktiviteti më i ri i përfshirë në fazën e dytë të projektit “Platforma kundër varfërisë së fëmijëve dhe përjshimit social të komuniteteve rome në Shqipëri”

Ky aktivitet do të kontribuojë në rritjen e aftësive prindërore të prindërve Rom dhe veçanërisht të nënave Rome. Aktiviteti ka për qëllim të mbështesë fuqizimin e gruas dhe të përmirësojë aftësitë dhe njohuritë rreth zhvillimit të fëmijërisë së hershme për nënat rome dhe njëkohësisht të përmirësojë arritjet e fëmijëve të vegjël.



Për zbatimin e këtij projekti, në çdo zonë do të angazhohen lehtësuese për organizimin e seanceve me nënat. Lehtësueset ju nënshtruan një trajnimi të organizuar nga Unioni Amaro-Drom, ku u njohën me metodologjinë e këtij aktiviteti.

Seancat organizohen në mënyrë të tillë ku nënat takohen me njëra tjetrën në praninë e një lehtësueseje të trajnuar, në mënyrë periodike dy herë në muaj,

në grupe të përbëra nga 15 nëna. Gjatë çdo seance, antarët e grupit marrin libra me përralla për fëmijë, kryesisht nga ato që përmbajnë mesazhe mbi ndjenjat e fëmijëve, sjelljet etj. Nënat lexojnë me rradhe librat, ndërkohë që lehtësueset i drejojnë ato dhe nxisin diskutime në lidhje me elementët e historisë dhe figurat. Kjo teknikë konstruktive e leximit, i nxit lexuesit të eksplorojnë tekstin dhe të kuptojnë më mirë përmbajtjen. Duke i angazhuar nënat në këtë mënyrë, lehtësuesja u mëson nënave një teknikë leximi të cilën ato mund ta zbatojnë në shtëpi me fëmijët e tyre. Në fund të çdo seance, librat u dhurohen nënave. Në këtë mënyrë ato kanë mundësinë që të krijojnë një bibliotekë në shtëpi dhe t’u lexojnë librat të vegjëlve të tyre. Ajo që është e veçantë për këtë aktivitet është se nuk fokusohet vetëm te fëmijët por edhe te nënat gjithashtu.

Ndër të tjera, lehtësueset inkurajojnë gratë pjesëmarrëse në seancë që të shprehin ndjenjat e tyre dhe vështirësitë që hasin gjatë prindërimit, të ndajnë historitë e tyre etj.

Duke ofruar mbështetje brenda antarëve të grupit, aktiviteti synon të arrijë rezultate pozitive duke fuqizuar komunitetin e grave dhe familjet e tyre.

KËSHILLA MIQËSORE PËR PRINDËRIT

Prindi është faktori më përgjegjës për zhvillimin e duhur të fëmijës, për krijimin e një atmosfere të shëndoshë dhe edukative në shtëpi, për organizimin e jetës, si dhe për përzgjedhjen me kujdes të metodave të edukimit në familje, në përshtatje me rrethanat familjare dhe veçoritë e fëmijës së tij.

Kujdesi dhe edukimi i prindërve, përveç që duhet të orientohet nga aspekti i zhvillimit fizik-motorik, njohës, emocional, etj, ai duhet të bëjë përpjekje edhe për kultivimin të fëmija e disa vetive që janë vendimtare në formimin e personalitetit dhe përgatitjen e tij, për jetën.

Prindërit duhet:

- T'u mundësojnë fëmijëve një fëmijëri të lumtur, që ata të ndihen të kënaqur dhe të mbështetur në çfarëdo aspekti, kurdo që ata janë në vështirësi .
- T'u ofrojnë fëmijëve, sa më shumë dashuri që të rriten me ndjesinë se, të japësh dhe të marrësh dashuri të bën të ndjehesh mirë me veten.
- T'u ofrojnë fëmijëve siguri, jo vetëm fizike por edhe t'u krijojnë një jetë pa ndryshime të shpeshta dhe drastike që i bën të ndjehen të pasigurt.
- T'u ofrojnë fëmijëve mundësi për krijimin e ndjenjës së pavarësisë, pasi ata kanë shumë energji dhe dëshirë për të njohur, eksploruar botën. Ky atribut i tyre, duhet të nxitet e të kultivohet nga ana e prindit, si një dëshirë shumë pozitive.
- T'u ofrojnë fëmijëve mundësi motivuese, që të ndihen krenar me veten, t'u nxisin talentin, duke mbështetur sjelljet e mira, sukseset në lojëra, duke i lavdëruar dhe duke i bërë që të ndihen mirë me atë çfarë janë. Sepse, fëmijët kanë nevojë t'u theksohen pikat e tyre të forta; veprimet, mënyrën si mendon, mënyra si luan, si buzëqesh, si këmbëngul, mënyra si i përballojnë zhgënjimet, si reziston, etj.
- T'u zhvillojmë shpresën, se kërkesat e tij, mund të realizohen, nëse mësohet të presë dhe të zhvillojë ndjeshmërinë e duhur, për kuptimin e situates. Është e gabueshme, t'u thuhet fëmijëve, një jo e pa argumentuar. Gjatë argumentimeve, fëmija kupton dhe pajtohet me mos plotësimin e kërkesave të tij të paarsyeshme.

Këtotribute të personalitetit, prindi nuk mund t'i avancojë tek fëmija, vetëm gjatë kohës sa ai është në shtëpi, sepse pjesën kryesore të ditës, ai qëndron në institucion parashkollor. Prindi këto mund t'i realizojë, vetëm përmes një bashkëpunimi të qëllimshëm me edukatoren, e cila gjithsesi, që duhet të ketë qasje profesionale si ndaj fëmijës, ashtu edhe ndaj partneritetit me prindërit. Prindi po ashtu, duhet të jetë i ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka edukatorja, për zhvillimin e fëmijës së tij. Kjo rezulton nga fakti se fëmija, një pjesë të ditës e kalon në institucionin parashkollor. Prindi është burimi i vetëm dhe më i rëndësishëm i informacioneve lidhur me fëmijën. Prandaj, ai duhet të krijojë raport bashkëpunues me edukatoren, t'i besojë asaj dhe të transmetojë tek ajo, në mënyrë të sqartë, informacione e të dhëna, lidhur me fëmijën. Kurse edukatorja, duhet ta respektojë e ta dëgjojë me vëmendje prindin. T'i marrë parasysh të gjitha ato që i thotë ai për fëmijën e vet, sepse këto e ndihmojnë shumë atë (edukatoren), në njohjen e fëmijës dhe në trajtimin, sipas nevojave që ai ka. Pra, bashkëpunimi reciprok, është domosdoshmëri për edukatoren dhe shumë stimules

për prindin, i cili e ka fëmijë në kopsht. Prania e prindit në institucionin parashkollor, është nevojë e domosdoshme. Mirëpo, prindi ka nevojë për përkrahjen e edukatores dhe nga përkrahja dhe qasja e saj, varet edhe prania e tij në institucion. Kështu që, për të qenë prindi bashkëpunues dhe aktiv, më funksional e më efektiv, duhet të inkurajohet nga edukatorja ose nga institucioni parashkollor. Afërsia dhe komunikimi mes prindit dhe edukatores, e ndihmon shumë punën e edukatores dhe e shton efikasitetin e shërbimit të përgjithshëm ndaj fëmijës. Njëkohësisht, ky bashkëpunim, është edhe emancipues për prindin dhe shton përkujdesin e duhur, të prindit ndaj fëmijës së tij. Kështu, ai përmes lojës dhe përkushtimit që bën ndaj fëmijës në shtëpi, e plotëson edukatoren, në ato çka ajo nuk ka mundur t'i arrijë në kopsht me të. Ky lloj reciprociteti, patjetër që reflekton, përveç në zhvillim të fëmijës, edhe në disponimin, vetëbesimin, sigurinë dhe mirëqenien e tij fizike, psikike e shpirtërore.

Ndërkohë familja, prindi duhet ta njohë dhe ta respektojë profesionin, njohuritë dhe eksperiencën e edukatores. Duke kontribuar në një respekt dhe sinqeritet reciprok, prindi nuk duhet të ngurojë, të komunikojë me edukatoren në forma e alternativa, që janë të mundshme dhe të përshtatshme siç janë; takime sipas nevojave, shkresa, biseda përmes telefonit, informim përmes fotove, etj. Prindi duhet të jetë ndihmës i edukatores, për zhvillimin e fëmijës në çdo aspekt. Ai duhet të kontribuojë edhe në realizimin e qëllimit të programeve, të aktiviteteve më fëmijët. Dihet që edukatorja, është ekspert në aspekt pedagogjik, kurse prindërit kanë njohuri nga përvoja jetësore, për fëmijët që i rrisin dhe dinë gjithçka për fëmijët e tyre. Kështu që ata mund të punojnë së bashku, për të mbështetur fëmijën në përfitime të zhvillimit të shumanshëm, në vlerësim të fëmijës, po ashtu edhe në shtimin e të nxëniet në shtëpi edhe pas orarit të qëndrimit të fëmijës, në institucionin parashkollor.

Marrëdhëniet prind-edukatore, konsiderohen si të suksesshme, kur ata së bashku bëjnë plane të punës, bëjnë realizim të aktiviteteve me fëmijët, kur përcjellin zhvillimin e fëmijës, kur ata këmbëjnë informacion rreth fëmijës. Duke u angazhuar së bashku për fëmijën, arrijnë rezultate konkrete; tejkalojnë situata, ngecje ose vështirësi të natyrave të ndryshme si dhe sigurojnë zhvillim cilësor, të gjithanshëm e të shëndetshëm të fëmijës.

KËSHILLA MIQËSORE PËR EDUKATORET

Rëndësia e bashkëpunimit edukator - prind është përcaktuar si një ndër parimet kryesore të këtij niveli të edukimit. Prandaj, funksionimi i këtij komponenti, gjatë realizimit të punës me fëmijët e moshës parashkollore, është obligim i secilit institucion parashkollor në përgjithësi, dhe i secilës edukatore në veçanti.

Alternativat e bashkëpunimit me prindër, janë specifike për secilin vend, për secilën shoqëri dhe për secilën kulturë të familjes kurse edukatorja, gjatë praktikës së bashkëpunimit, duhet t'i ketë parasysh këto specifika.

Mirëpo, janë edhe disa strategji universale, të komunikimit me fëmijët, dhe të cilat, ndikojnë në krijimin e disa vetive, po ashtu universale, të cilat vlejné për të gjithë fëmijët e të gjitha shoqërive dhe kulturave.

Disa prej tyre mund të jenë:

- Mbledhje periodike të prindërve në ambientin e kopshtit, ku bashkëbisedohet për temat rreth funksionit dhe programit të kopshtit dhe informacione të përgjithshme për fëmijët.
- Konsultime të shkurtra, të përditshme me edukatoren, kur prindërit sjellin ose marrin fëmijët e tyre nga kopshti duke këmbyer informacione reciproke rreth fëmijës.
- Takime të posaçme, individuale të prindërve me edukatoren (dhe sipas nevojës), ku u jepet mundësia të dyve, që të japin mendime dhe vlerësime që kanë të bëjnë me zhvillimin e fëmijës.
- Kontakte telefonike, në rast se ka diçka më specifike për të cilën duhet të dijë prindi.
- Takime informuese me specialistët e fushës së arsimit parashkollor, në të cilat shqyrtohen temat që u interesojnë prindërve.
- Biseda konkrete me prindin, për çdo nevojë urgjente.

Edukatorka si eksperti i punës, ka përgjegjësinë për funksionimin e duhur të këtij bashkëpunimi. Ajo është kompetentja që transmeton informacionet e identifikuar rreth fëmijës, te prindi dhe ajo e cila kërkon informacion nga ai.

Nga qasja serioze ndaj çështjes së bashkëpunimit me prindër, varet edhe suksesi i përgjithshëm i punës së institucionit parashkollor, dhe i edukatores në veçanti.

Bashkëpunimi edukatore - prind, mund të jetë i suksesshëm, vetëm kur të dy palët, vazhdimisht përcjellin dhe kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin e gjithanshëm, të fëmijës. Edukatorka, gjatë punës së saj të përditshme, gjatë realizimit të aktiviteteve me fëmijët, duhet të bëjë vëzhgimin e përgjithshëm të tyre dhe në bazë të këtij, ajo di dhe mund të konstatojë përparimin e zhvillimit të fëmijëve në të gjitha aspektet; shkallën e angazhimit fizik të fëmijës, gjendjen emocionale e shpirtërore të tij, nivelin e ndërveprimit dhe socializimit, gatishmërinë për komunikim, si dhe aftësitë e tij specifike. Për të gjitha këto lloj zhvillimesh, edukatorka duhet ta informojë prindin, në mënyrë që ai të merret vazhdimisht që t'i perfeksionojë e kultivojë më shumë ato dhe në mënyrë

të veçantë, me pikat më pak të avancuara të fëmijës, që së bashku me edukatoren të ndikojë në forcimin e tyre.

Pa ndihmën e prindit, edukatorja e ka të pamundur të merret aq sa duhet dhe sa ka nevojë, me secilin fëmijë, në mënyrë të veçantë (për shkak të numrit të madh të fëmijëve, që ndodhen në grup). Po ashtu edhe prindi, pa komunikuar me edukatoren, e pa qenë i informuar për reflektimin e fëmijës së tij në lojë e në aktivitete të kopshtit, nuk mund ta trajtojë në mënyrë të duhur, fëmijën e tij në shtëpi. Sepse, dihet që secili fëmijë, është unik. Duke u nisur nga ky fakt, ndër parimet e edukimit parashkollor, është edhe parimi i respektimit të individualitetit tek fëmija. Për këtë arsye, prindi duhet të dijë çfarë të kërkojë nga edukatorja dhe çfarë t'i ofrojë asaj. Po ashtu edhe edukatorja, duhet të dijë çfarë të kërkojë nga prindi dhe çfarë informacione t'i japë atij rreth fëmijës, i cili është një objektivë e përbashkët e tyre. Si rezultat i një bashkëpunimi profesional nga ana e edukatores, dhe i një bashkëpunimi serioz e të përkushtuar nga ana e prindit, fëmija është i shëndetshëm, i zhvilluar gjithanshëm, i trajtuar mirë e drejt, si në kopsht ashtu edhe në shtëpi. Kështu, puna në institucione parashkollore ,do të jetë më cilësore dhe më e suksesshme. Familja-prindërit, do ta kenë më të lehtë , ta rrisin fëmijën dhe do të jenë më të lumtur, me zhvillimin e tij. Ky rezultat, arrihet tek të gjithë fëmijët (tek të gjithë në mënyrë relative), atëherë kur edukatorja, prindin e sheh, e trajton, si partnerin më të mirë e më të besueshëm, për punën me fëmijën, si dhe atëherë kur institucioni parashkollor, ka qasje profesionale ndaj prindit dhe në vazhdimësi komunikon me të, konsultohet për gjithçka rreth fëmijës, e përfshinë në përpilimin e planeve të punës, në organizimin e projekteve, në realizimin e shumë temave dhe aktiviteteve të punës. Meqenëse bashkëpunimi me prindër, nuk është aspak i thjeshtë dhe duhet të jetë shumë përmbajtjesor dhe i efektshëm, si kriter kyç i një bashkëpunimi të tillë, duhet të jetë përshtatshmëria me kulturën familjare. Edukatorja duhet ta njohë dhe ta respektojë mentalitetin dhe nivelin intelektual të prindit-familjes, së fëmijës. Kjo edhe i përcakton ose kushtëzon, alternativat e komunikimit dhe të bashkëpunimit me të. Pastaj, bashkëpunimi kushtëzohet, edhe nga struktura familjare e fëmijës (a i ka ai të dy prindërit dhe me cilët anëtarë të familjes jeton).. Sepse anëtarët tjerë të familjes së fëmijës (që i mungon njëri ose të dy prindërit) dhe prindërit me nivel më të mangët kulturor dhe emancipues, janë më të ngurtë dhe jo shumë të afërt, në komunikim . Pastaj, disa nga prindërit, me vështirësi e pranojnë problemin, ngecjen apo të metat e fëmijës. Ky nivel i prindërve kanë një lloj frike, të ndërhyjnë në punët e institucionit dhe në trajtimin e fëmijës së tij. Kështu që, nevojitet që edukatorja, të jetë e përgatitur në mënyrë profesionale, (përfshirë edhe aspektin psikologjik të qasjes) që bashkëpunimin me prindër, t'ia përshtatë nivelit të edukimit dhe specifkave familjare. Një komunikim i tillë (edukator-prind), ia lehtëson shumë punën me fëmijët vet edukatores, dhe prindërve u mundëson një trajtim të nevojshëm ndaj fëmijës së tyre. Si e tillë (edukatorja e përgatitur profesionalisht), inkurajon të gjithë prindërit, për bashkëpunim e informim reciprok rreth fëmijës dhe ky reciprocitet, patjetër që do të sigurojë „përfitime“ për fëmijën, prindin dhe vet institucionit parashkollor. Pra, angazhimi i prindërve, është një element shumë domethënës, për institucionin parashkollor. Mirëpritja, duhet të fillojë, që në takimin e parë të tyre, me edukatoren-institucionin. Prindërit, duhet të konsiderohen si specialistë, për fëmijët e tyre dhe si pjesëmarrës aktiv, në procesin e zhvillimit dhe të edukimit të këtyre fëmijëve. Prandaj është e preferuar që, të gjitha institucionet parashkollore, ta vlerësojnë dhe ta institucionalizojnë, partneritetin „edukator-prind“.

Botim i Unionit “Amaro-Drom” Nr. 3, Dhjetor 2017